



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/03
Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafët 3 dhe 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5, paragrafi 1, lidhur me nenin 7, paragrafin 3, dhe nenin 19, paragrafin 3, të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009, dhe pikën 4 të Rezolutës 06/R-013 të 12 korrikut 2018 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Telekomi i Kosovës" Sh.A.
2. Shfuqizohen vendimet 09/38 i 29 marsit 2018, 10/81 i 24 dhjetorit 2018 dhe 03/106 i 11 qershorit 2019 të Qeverisë për emërimin e drejtorëve.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Për të vlerësuar gjendjen, është marrë parasysh Raporti i auditimit të Ndërmarrjes "Telekomi i Kosovës" për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2018, nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).


Sipas nenit 7.3 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Qeveria mund t'i shkarkojë drejtorët nëse, për dy vjet radhazi, ndërmarrja nuk përmbush planin e biznesit, u bie vlera asetëve të ndërmarrjes, ose rritet pakënaqësia e konsumatorëve me shërbimet. Duke u mbështetur në raportin e ZKA-së (fq. 15-20, 27, 51-52), Qeveria konstaton se janë plotësuar kushtet për shkarkimin e drejtorëve.

Sipas nenit 19.3, Qeveria duhet t'i shkarkojë drejtorët menjëherë nëse ka "arsye për të besuar" se kanë shkelur detyrat fiduciare. Duke pasur parasysh raportin e ZKA-së (fq. 9-10, 20-27), Qeveria vëren se drejtorët kanë lejuar shpenzime të tepërta, punësime e gradime pa kriter, si dhe kontrata për mallra e shërbime, në kundërshtim me mundësitë, nevojat dhe zotimet e ndërmarrjes për ulje shpenzimesh e rritje të hyrash. Rijedhimisht, Qeveria konstaton se ka arsye për të besuar se drejtorët kanë shkelur detyrat fiduciare, për çka duhet të shkarkohen.

Përfundimisht, pika 4 e Rezolutës 06/R-013 të Kuvendit të Republikës së Kosovës gjithashtu kërkon shkarkimin e drejtorëve të ndërmarrjes. Sipas nenit 92, paragrafit 3, të Kushtetutës, Qeveria duhet t'i zbatojë rezolutat e Kuvendit.

Prandaj, mbështetur në normat dhe gjetjet e sipërcekura, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Telekomi Kosovës" Sh.A.